



**FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS**  
**KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION**

Shtëpia e Sporteve, rr. Ramiz Sadiku Nr 43, zyra nr 7, Prishtinë  
Tel: +383-44-170-586 / Email: [info@fppk.com](mailto:info@fppk.com)

# **FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS**

## **RREGULLORE**

**PËR HARTIMIN E RANGLISTËS SË FEDERATËS SË PINGPONGUT TË  
KOSOVËS**

Prishtinë 2023

Në përputhje me nenin 15 paragrafi 2.1 të Statutit të Federatës së Pingpongut të Kosovës të datës 10 nëntor 2020, Federata e Pingpongut e Kosovës, në mbledhjen e datës: 25/02/2023 miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR HARTIMIN E RANGLISTËS SË FEDERATËS SË PINGPONGUT TË KOSOVËS**

### **Neni 1. Qëllimi**

1. Me këtë Rregullore vërtetohet mënyra e vlerësimit të rezultateve të arritura në garat e pingpongut, nga e cila del edhe vlerësimi i suksesshmërisë së përgjithshme të garuesve në formë të ranglistës.
2. Suksesshmëria e tërësishme e garave vërtetohet në fund të stinorit garues-rangimi për tërë vitin. Po ashtu vërtetohet edhe rangimi aktual pas çdo gare që pikëzohet gjatë stinorit garues.

### **Neni 2. Kategoritë**

1. Ranglistat përgatiten për të gjitha kategoritë sipas moshës, dhe të dy gjinitë. Me rastin e vërtetimit të pozitës në ranglistë merren parasysh vetëm rezultatet e arritura në kategorinë e caktuar.
2. Në fillim të stinorit garues, Kuvendi i FPPK-së përcakton garat të cilat do të pikëzohen për ranglistë në stinorin vijues.

### **Neni 3. Vlefshmëria e rezultateve**

Vlefshmëria e rezultateve sportive shprehet në pikë. Pikët ndahen në bazë të fitoreve individuale, si dhe për plasmanin e arritur, sipas kriterëve të vërtetuara me këtë Rregullore.

### **Neni 4. Renditja**

1. Ranglistat, sipas të cilave pikëzohen fitoret vetjake, i renditin lojtarët në shtatë kategori:

Kategoria I	vendi 1-2
Kategoria II	vendi 3-4
Kategoria III	vendi 5-8.
Kategoria IV	vendi 9-16
Kategoria V	vendi 17-32.
Kategoria VI	vendi 33-64.
Kategoria VII	të tjerët.

2. Në rast se dy e më shumë lojtarë kanë pikë të barabarta në rastet e hedhjes së shortit për garë do të merret për bazë renditja alfabetike, ndërsa në rastet e përzgjedhjes në

përfaqësuese do të vlerësohet plasmanin më i lartë në grupmoshën përkatëse në aktivitetet si në vijim:

- a. turneu top 8
- b. kampionati individual
- c. kampionati ekipor
- d. turneu kualifikues në rast të mos përzgjedhjes më lart

3. Për lojtarët e huaj të cilët luajnë në klubet tona, si dhe për lojtarët tanë që luajnë në klubet e huaja, rangimin e caktojnë trajnerët e përfaqësueses.

### **Neni 5.**

#### **Lojtarët e regjistruar**

Ranglistat e FPPK-së përgatitet vetëm për lojtarët dhe lojtaret që janë të regjistruara në FPPK.

### **Neni 6.**

#### **Pikët shtesë**

**1. Vërejtje:** Neni 6 **nuk** do të aplikohet menjëherë për shkak të mungesës së programit përkatës për momentin. Ky nen do të shqyrtohet nga Kuvendi në baza vjetore dhe Kuvendi do të marrë vendim të veçantë për hyrjen në fuqi të tij. Mbetet obligim i FPPK që deri atëherë të sigurojnë një program që do të mundësonte llogaritjen e ranglistës sa më të përafërta me këto nene.

2. Në të gjitha garat pikëzuese, përveç pikëve që fitohen sipas tabelës 1 e cila është paraqitur në fund të kësaj rregulloreje, lojtarët për çdo fitore ndaj lojtarit të

Kategoria I	fitojnë 25 pikë
Kategoria II	fitojnë 20 pikë
Kategoria III	fitojnë 15 pikë
Kategoria IV	fitojnë 10 pikë
Kategoria V	fitojnë 05 pikë
Kategoria VI	fitojnë 03 pikë.
Kategoria VII	fitojnë 01 pikë

### **Neni 7**

#### **Numri i të paraqiturve në garë**

1. Nëse në një garë në konkurrencën e meshkujve paraqiten më pak se 32 pjesëmarrës, për plasman nën vendin e 16-të lojtarët fitojnë 50% të pikëve të parapara për atë garë. Në konkurrencën e femrave nëse paraqiten më pak se 16 pjesëmarrëse për plasman nën vendin 8 lojtaret fitojnë 50% të pikëve të parapara për atë garë.

2. Nëse garuesi e fiton lojën për shkak të mungesës së kundërshtarit, ai i fiton 100% të pikëve të parapara sipas tabelës 2, për atë nivel në rast se pëson humbje në nivelin tjetër

## **Neni 8 Bartja e pikëve**

Pikët e fituara në kategorinë më të lartë nuk vlejnë edhe për kategorinë më të ulët, edhe anasjelltas.

## **Neni9 Garat që pikëzohen**

1. Garat të cilat pikëzohen për ranglistë në kategorinë sipas moshës janë:

- 1.1. Kampionati individual i Kosovës
- 1.2. Kampionati ekipor i Kosovës
- 1.3. Turnetë e pranuar dhe mbështetura nga FPPK
- 1.4. Top- turnetë

## **Neni 10. Pikët mbrojtëse**

1. Lojtarit të përzgjedhur i takojnë pikët mbrojtëse nëse ai nuk paraqitet në garë për shkak të pjesëmarrjes në përfaqësuese. Në këto raste lojtarit i takojnë pikët sipas tabelës 1.

2. Tabela e pikëzimit për pikët mbrojtëse

Tabela 1

<b>Pjesëmarrja</b>	<b>1 fitore</b>	<b>2 fitore</b>	<b>3 fitore</b>	<b>4 fitore</b>	<b>5 fitore</b>	<b>6 fitore</b>	<b>7 fitore</b>	<b>8 fitore</b>	<b>9 fitore</b>	<b>10 fitore</b>
<b>R</b>	<b>R1</b>	<b>R2</b>	<b>R3</b>	<b>R4</b>	<b>R5</b>	<b>R6</b>	<b>R7</b>	<b>R8</b>	<b>R9</b>	<b>R10</b>
<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>
<b>150</b>	<b>175</b>	<b>200</b>	<b>225</b>	<b>250</b>	<b>275</b>	<b>300</b>	<b>325</b>	<b>350</b>	<b>375</b>	<b>400</b>

## **Neni 11. Pikëzimet**

1. Nëse lojtarët në turne nuk mund të fitojnë asnjë ndeshje në grupe do të fitojnë 3 pikë për pjesëmarrje (P). Lojtarët që fitojnë ndonjë ndeshje në grup, po jo mjaftueshëm për të kaluar grupin fitojnë 5 pikë për fitore në grup (FG).

## 2. Tabela për pikëzimin nga turnetë

Tabela 2

TURNET		Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi	Vendi		
		<b>1</b>	<b>2</b>	<b>03-4</b>	<b>5-8</b>	<b>9-16</b>	<b>17-32</b>	<b>33-64</b>	<b>65-128</b>	<b>FG</b>	<b>P</b>	<b>M</b>	<b>Mt</b>	
		<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	<i>Pike</i>	
1	<i>Turnetë e që shpërblehen nga FPPK-ja<sup>1</sup></i>	250	200	150	120	80	40	20	10	5	3	-50	-100	
2	<i>Turnetë tjera<sup>2</sup></i>	200	150	120	80	40	20	10	5	5	3	-50	-100	
3	<i>Turnet "TOP 8" dhe "TOP 12"</i>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>					
		250	200	150	120	100	90	70	60				-50	-100
		<b>9</b>	<b>10</b>	<b>11</b>	<b>12</b>									
		50	40	30	20									

## 3. Tabela për pikëzimin nga garat ekipore

Tabela 3

Kategoria	Fitore	Humbje
<b>Superliga</b>	18	6
<b>Liga e pare</b>	12	4
<b>Liga e dytë</b>	6	2
<b>Ligat e të rinjve</b>	12	4

### Neni 12

#### Mungesa në gara

1. Lojtarët që paraqiten në short e nuk marrin pjesë në garë do u zbriten 50 pikë nga ranglista, (M = -50), ndërsa për mungesë në TopTurne u zbriten 100 pikë nga ranglista (Mt = -100)

2. dispozita e paragrafit të parë të këtij neni nuk do të zbatohet nëse lojtari ose klubi i tij dorëzon në ditën e garave dëshmi të pranueshme për mungesën e arsyeshme.

3. Në rast të diskualifikimit të ekipeve për shkak të mungesave në më shumë se tri gara ekipor, klubi nuk do të përfshihet në subvencione të mundshme nga federata për periudhë 1 vjeçare.

### Neni 13

#### Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Rregullorja për hartimin e ranglistës e vitit 2019.


## **Neni 14**

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 1 ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i FPPK-së dhe e njëjta publikohet në faqen zyrtare të Federatës.

Kryetari i FPPK

Jeton Beqiri

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Jeton Beqiri', is written over the printed name.